

PSH .nr. 1028/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: Z. Blerim Dina - Kryetar, Z. Nuhi Paçarizi - Referues, Z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i operatorëve ekonomik “Saba Belca SB Construction & Gurebardhi SHPK”-Obiliq, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë “Integral SHPK & Milenium Konstruktion SHPK”-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Vazhdimi i rrugës B-Pjesa e dytë” me nr. të prokurimit: 616-19-1015-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më datën: 15.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e grupit të operatorëve ekonomik “Saba Belca SB Construction & Gurebardhi SHPK”-Obiliq, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Vazhdimi i rrugës B-Pjesa e dytë” me nr. të prokurimit: 616-19-1015-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

II. VËRTETOHET, njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Vazhdimi i rrugës B-Pjesa e dytë” me nr. të prokurimit: 616-19-1015-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e grupit të operatorëve ekonomik “Saba Belca SB Construction &Gurebardhi SHPK”-Obiliq, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Grupi i operatorëve ekonomik “Saba Belca SB Construction &Gurebardhi SHPK”-Obiliq, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 30.11.2020 me nr. 1028/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Vazhdimi i rrugës B-Pjesa e dytë” me nr. të prokurimit: 616-19-1015-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 7, 59, 60, 65 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe 28 dhe 41 të RRUOPPsë.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 01.12.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja shqyrtuese e prokurimit në raportin e dt: 10.12.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Sa i përket vlerësimit të pretendimeve:

Ekspertja Shqyrtuese sqaron se, aktiviteti i prokurimit “**Vazhdimi i rrugës B-Pjesa e dytë**” me nr të prokurimit **616-19-1015-5-1-1**, ka bërë hapjen e ofertave me datën 26.12.2019, ku pas vlerësimit të ofertave është rekomanduar OE “Saba Belca& SB Construction SHPK& Gurëbardhi SHPK”, por pas kërkesës për rishqyrtim të OE “Integral Shpk&Milenium Konstruktion”Shpk, AK ka aprovuar kërkesën për rishqyrtim duke e kthyer aktivitetin e prokurimit në rivlerësim pasi ankuesi në fjalë ka sqaruar AK-së në detaje kontratat për punë të ngjashme dhe po ashtu kanë bashkangjitur në kërkesën për rishqyrtim edhe pozicionet brenda kontratave, e ku në këto pozicione janë kryer punime dhe ndërtime të rrugëve, të cilat pozicione autoriteti

kontraktues i kishte marr parasysh me rastin e rishqyrtimit dhe rivlerësimit.

Më pastaj AK-ja ka nxjerr njoftimin mbi vendimin tjetër ku ka rekomanduar OE në fjalë "Integral Shpk&Milenium Konstruktion" Shpk për kontratë. Pas këtij njoftimi kishte parashtruar ankesë në OSHP operatori ekonomik "Saba Belca Dega në Kosovë & SB Construction Shpk & Gurëbardhi Shpk", ku pastaj Paneli i OSHP-së ka nxjerr një vendim 317/20 dt 10.07.2020, dhe ka kërkuar që ky aktivitet i prokurimit të kthehet në rivlerësim:

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues nuk e ka bërë ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve konform nenit 59 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që gjatë rivlerësimit dhe krahasimit të tenderëve të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së lidhur me natyrën e punëve dhe nëse kontratat e kontestuara janë brenda 3 viteve të fundit sikurse ka kërkuar AK në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit. Pas sqarimit të natyrës së këtyre kontratave dhe afateve, AK të bëjë ekzaminimin dhe vlerësimin e tenderëve në pajtim me nenin 59 të LPP-së.

Pas vendimit të PSH 317/20, AK ka kthyer Aktivitetin e prokurimit në rivlerësim ku pastaj ka rekomanduar për kontratë OE "Saba Belca&GurëbardhiSHPK", me tutje pas këtij vendimi të AK-së, kemi pranuar ankesë nga OE "Integral SHPK&Milenium Construction", ankesa e të cilit është aprovuar si e bazuar- PSH 692/20 dt: 20.10.2020 dhe aktiviteti prap është kthyer në rivlerësim, dhe tani AK më 10.11.2020 ka rekomanduar për kontratë OE "Integral SHPK&Milenium Construction SHPK", ndërsa OE "Saba Belca&Gurëbardhi SHPK" kanë parashtruar ankesë në OSHP pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga AK.

OE ankuesi "Saba Belca SHPK&Gurëbardhi SHPK" pretendojnë se OE i rekomanduar nuk i plotëson kriteret dhe është i papërgjegjshëm:

1. PRETENDIMET ANKIMORE PËR OE TË PROPOZUAR PËR DHËNIE

GOE i cili pas vendimit të fundit propozohet për shpërblim me kontratë, nuk plotëson shumicën e kriterëve të dhëna nga AK. Ky konsorcium gjatë dy vlerësimeve nga komisioni vlerësues është eliminuar për arsyen: "Nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme, (ndërtim i ultë) në vlerë minimale prej 3,000,000,00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë).

Ky konsorcium në ofertën e tyre ka përfshirë edhe kontrata të mirëmbajtjes dimërore që asesi nuk mund të jetë punë e ngjashme si dhe mirëmbajtjet verore. Poashtu këto mirëmbajtje hyjnë në kontrata për shërbime dhe jo kontrata pune siç është ky aktiviteti i prokurimit. Gjithashtu shihet se së bashku si konsorcium kanë më pak se 1 milion euro kontrata të natyrës së ngjajshme për 3 vitet e fundit. AK më saktësisht Udhëheqësi i Departamentit të Prokurimit ka marrë parasysh edhe disa pozicione të kontratës së mirëmbajtjeve për plotësimin e këtij kriteri mirëpo i ka anashkaluar pa i analizuar edhe shumë kontrata të cilat i ka përfunduar në fund të vitit 2016 duke kërkuar nga kompania situacionet e tyre dhe të shihet se a e plotësojnë kriterin për

realizimin e këtyre kontratave brenda 3 viteve të fundit. Pra më saktësisht kontrata: “Asfaltimi i rrugës në Merdar” me vlerë prej 194,187.69 Euro ka përfunduar me 20.12.2016.

“Asfaltimi i disa rrugëve në lagjen Ajeti në fshatin Sfeqël” me vlerë prej 63,952.67 Euro e datës 19.12.2016, dhe afati kohorë i kërkesës për pranim teknik të punëve është zakonisht 5 deri 10 ditë, atëherë shihet shumë qartë se ekzekutimi i punëve lidhur me këto kontrata është në kundërshtim me kriteret e përzgjedhjes në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit d.m.th nuk është respektuar neni 59.4 i LPP-së, (d.m.th jashtë periudhe 3 vjeçare nga njoftimi për kontratë) gjithashtu ekspertët nuk janë lëshuar në fakte dhe prova që shumë lehtë kanë mund ti vërtetojnë dhe të argumentohet se këto kontrata janë ekzekutuar jashtë periudhës 3 (tri) vjeçare nga njoftimi për kontratë dhe nuk duhet të pranohen, vetëm pse e kanë datën e pranimit brenda periudhës 3 (tri) vjeçare nga njoftimi për kontratë.

Po ashtu shumë kontrata të tjera që kanë filluar në vitin 2014, 2015. Pra me të gjitha përpjekjet nga AK për të arritur vlerën e kërkuar shihet qartë se GOE nuk e plotëson këtë kriter. Në dosjen e Tenderit nuk kërkohen pozicione të ngjashme por kërkohen kontrata të ngjashme.

Ekspertja Shqyrtuese sqaron: në ekspertizën e kaluar më datë 20.10.2020 PSH 692/20, lidhur me pretendimin e lartëpërmenduar nga OE ankuesi e i cili pretendim ka qenë po thujse i njëjti, ka sqaruar se, sa i përket projekteve mirëmbajtja e rrugëve dimërore dhe verore e cila më tepër është bazuar nga eksperti teknik i jashtëm i cili ishte i involvuar në lëndën 317/20 dt.10.07.2020 për të njëjtin pretendim, si rrjedhojë eksperti teknik ka sqaruar se disa nga pozicionet në projektet e mirëmbajtjeve dimërore dhe verore janë të natyrës ndërtim i ulët e të cilat përkojnë me kërkesën e AK-së, andaj ky aktivitet i prokurimit ka vazhduar në rivlerësim me qëllim që të rivlerësohen dhe ekzaminohen ofertat prej fillimit nga pika zero, ku AK ka vlerësuar se pozicionet janë të mirëqenë dhe përkojnë me natyrën e ngjajshme!

Ekspertja tutje sqaron, OE ankuesi në ankesë ka pretenduar po ashtu se disa kontrata nuk janë brenda afatit kohor të përfunduara brenda 3 viteve nga data e njoftimit për kontratë. Pra më saktësisht kontrata: “Asfaltimi i rrugës në Merdar” me vlerë prej 194,187.69 Euro ka përfunduar me 20.12.2016.

“Asfaltimi i disa rrugëve në lagjen Ajeti në fshatin Sfeqël” me vlerë prej 63,952.67 Euro e datës 19.12.2016.

Ekspertja Shqyrtuese sqaron se, ky pretendim nuk qëndron sepse kontratat “Asfaltimi i rrugës në Merdar” me vlerë prej 194,187.69 dhe “Asfaltimi i disa rrugëve në lagjen Ajeti në fshatin Sfeqël” me vlerë prej 63,952.67 Euro në ofertën e OE të rekomanduarit në listë janë brenda afatit nga data e njoftimit publikimit për kontratë pra 02.12.2016-02.12.2019.

Ekspertja Shqyrtuese sqaron se, OE ankuesi tutje në këtë pretendim shton se: “Komisioni i rivlerësimit në këtë rast ka vepruar drejtë duke mos i marrë parasysh kontratat për shërbim, ndërsa Udhëheqësi i Departamentit të Prokurimit e refuzon rekomandimin e tyre dhe merr vendim që të shpërblej me kontratë Grupin e Operatorëve Ekonomik Integral&Millenium duke mos kërkuar as edhe sqarim shtesë për këto kontrata. Pra Udhëheqësi i Departamentit të Prokurimit ka vepruar në kundërshtim me vendimin e Panelit Shqyrtues me nr. 317/20”

Ekspertja Shqyrtuese sqaron se pretendimi gjendet pjesërishtë i qëndrueshëm, Komisioni i vlerësimit në rivlerësim, nga 3 anëtarë të komisionit 2 kanë qenë kundër OE të rekomanduarit, gjerësa njëri ka qenë pro rekomandimit, mirpo konform Rruopp-së pika 40.13 vendimi përfundimtar i mbetet ZPP-së citat”

40.13 Vendimi përfundimtar mbi dhënien e kontratës mbetet përgjegjësi e Zyrtarit përgjegjës të Prokurimit. Zyrtari përgjegjës i Prokurimit mund të pranojë rekomandimin e komisionit apo refuzojë atë. Kur refuzohet rekomandimi i komisionit, Zyrtari përgjegjës Prokurimit do të shpjegojë arsyet me shkrim. Në situata të tilla Zyrtari përgjegjës i Prokurimit mund të nxjerr vendimin përfundimtar ose mund të formoj komision të ri për ri-vlerësim. Shpjegim i tillë do të përfshihet në procesverbalin e aktivitetit të prokurimit. ZKA i AK-së menjëherë do të informohet për këtë refuzim. Informacioni duhet të jepet me shkrim.

(Shih lartë tek raporti i rivlerësimit).

2.Pretendimi i OE ankuesit kundër OE të rekomanduarit:

Tek dokumentet e dorëzuara të personelit i cili do të jetë i angazhuar në këtë projekt nga kompania e shpërblyer me kontratë shihet se GOE Integral Shpk&Millenium Construction nuk plotëson gati asnjë nga këto kritere.

Për: a)Inxhinier i diplomuar i hidroteknikes dhe b) Inxhinier i diplomuar i elektroteknikes (drejtimi energjetike) nuk plotësohet kriteri për udhëheqje të kontratave të natyrës së ngjajshme pasi referencat e tyre janë për projekte të tjera.

Ekspertja Shqyrtuese konsideron se pretendimi i OE ankuesit është shqyrtuar në vendimin 317/20 dt.10.07.2020, dhe se OE i rekomanduar ka të bashkangjitur referencat për inxhinierët në fjalë.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues “SABA BELCA; SB CONSTRUCTION SH.P.K; GURËBARDHI SH.P.K”- Obiliq, se inxhinieri i hidroteknikës dhe inxhinieri i elektros, ofruar nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës, nuk e plotësojnë kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë ku kërkohet: “Referenca për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit”. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ky pretendim ankimor është i pa bazuar pasi që këto referenca i ka bashkangjitur eksperti në ekspertizën e tij.

3.Pretendimi i OE ankuesit kundër OE të rekomanduarit:

Ne kemi dyshuar prej fillimit se Operatori Ekonomik "GOE Integral Shpk&Millenium Construction" ka paraqitur dokumente të rreme dhe kemi paraqitur dyshime të cilat i kemi cekur në Përgjigjen ndaj mendimit të ekspertit të datës 15.06.2020 por që nuk janë investiguar dhe nuk janë hulumtuar si duhet dhe as që nuk është urdhëruar AK për verifikimin e këtyre dokumenteve të ofruara. AK në anën tjetër ex-officio është dashur të bëjë verifikimin e këtyre dokumenteve të cilat nuk janë të dorëzuara origjinal. Ne si kompani është dashur që të vërtetojmë se a janë të gjitha dokumentet e ofruara të besueshme dhe personeli profesional a është në dijeni për angazhimin e tyre në këtë projekt.

Pasi që nuk është bërë nga AK verifikimi i dokumenteve, ne kemi bërë kërkesë drejtuar Sokol Xhafës në emailin e tij zyrtar më datën 23.11.2020, se a është i agazhuar si Inxhinier i Diplomuar i Hidroteknikës me dijeninë e tij për arsye se nënshkrimi i vendosur në Kontratën mbi vepër nuk është i njëjtë me atë në CV si dhe dokumenteve të nënshkruara në KRU Prishtina.

I nderuari z.Sokol Xhafa!

Shpresojmë se jeni mirë me shëndet dhe punët po ju ecin sipas planifikimit.

Aryseja që po ju shkruajm është se pa dijeninë e juaj është përdorur nënshkrimi juaj në dokumentin Kontratë mbi Vepër te datës 21.12.2019, për projektin Vazhdimi i rrugës B – Pjesa e dytë me Nr. prokurimi: 616-19-1015-5-1-1 nga Autoriteti Kontraktues: Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

Kërkojmë nga ana juaj që nga email-i juaj zyrtarë të na sqaroni ose deklaroni se a jeni nënshkrues i dokumentit të lartëcekur dhe a jeni i angazhuar në këtë projekt me dijeninë e juaj.

Nga dokumentet e ofruara në ofertë nga një Operatorë Ekonomik vërejmë se nënshkrimi i juaj në kontratë nuk përputhet me dokumentet si CV apo vendimeve të nënshkruara nga ana juaj si U.D. Kryeshef Ekzekutiv i KRU Prishtina SH.A.

Për mos me hyrë me thellë në organet kompetente si forenzik, për të vërtetuar nënshkrimin për sqarim Autoritetit

Kontraktues, shpresojmë që rruga më e mirë është deklarimi i juaj.

Pas disa kërkesave tek AK për "Zgjidhje preliminare të mosmarrëveshjeve" ku kemi kërkuar nga AK që të ju kontaktojë juve në lidhje me këtë çështje, mirëpo AK ka hezituuar të ju kontaktojë për arsye që nuk i dijmë prandaj po ju kontaktojmë ne.

Shpresojmë se do të kemi një përgjigje të shpejtë nga ana juaj edhe pse e dijmë angazhimin e juaj tanimë si udhëheqës i një ndërmarrje.

Të bashkangjitur gjeni Kontratë mbi Vepër, CV dhe raporti në KRU Prishtina i nënshkruar nga ju që jemi bazuar në nënshkrimin që ju e keni.

Me respekt,




Sokol Xhafa nga emaili i tij zyrtar ka sqaruar punën e tij se në cilën kompani ka punuar dhe për projektin në fjalë Vazhdimi i rrugës B-pjesa e dytë njofton kompaninë Saba Belca Dega në Kosovë dhe Komunën e Prishtinës se: **'' firmosja e kësaj kontrate mbi vepër me OE Milenium Konstruktion shpk nuk është bërë nga ana ime, shihet qartësisht që në kontratë nuk është firma (nënshkrimi im). Nënshkrimi im është në CV e bashkëngjitur, mirëpo CV-ja e bashkëngjitur është e vitit 2018, jo e vitit 2019''**

Pas njoftimit me përmbajtjen e Kontratës, kjo Kontratë nga palët kontraktuese u nënshkrua më datën: **21.12.2019** në Prishtinë, në: 2 kopje autentike, nga të cilat, secilës palë i mbeten nga një kopje.

Punëdhënësi:
Milim Allu



I Puntësuar:
Sokol Veli Xhafa



Udhi i punës, pozita
Përgjegjësi dhe aktivitet kryesor


Zëvendës Direktor, - krye inxhinier,
Menaxher i Projektime-Kontraktave, Dizajner-Projektues i objekteve ndërtimore, Person përgjegjës për
tashmë me investitorë siç janë: Komuna, Qeveria, Menaxher i Punëve, Udhëheqës në Objekt-
Kontrata etj.

Emri dhe Adresa e Punëdhënësit

WW"MAK-Building-sh.p.a", rr. Faruk Beutit 49, Vushtri, Kosovë

Page 1/3 - Curiculum vitae of
Xhafa Sokol

For more information or European go to <http://europass.cedefop.europa.eu>
© European Communities, 2003 20050609



Referenca	dt. 23.11.2020
Për:	Zyrën e Prokurimit – Komuna Prishtinë
Kopje:	Pales kërkuar OE: Saba Belca – Dega në Kosovë
Nga:	Sokol Xhafa
Lënda:	Përgjigje në Kërkesë

Te nderuar,

Ju informojmë se ne baze të kërkesës së OE "Saba Belca- Dega në Kosovë" të drejtuar në formë elektronike në e-mailin zyrtar me datë: 23.11.2020, ju përgjigjem në kërkesë si më poshtë:

Unë Sokol Veli Xhafa i datëlindjes 22.04.1985 me nr. Personal 2030491397, jam i punësuar në nivelin primar në KRU "Prishtina" sh.a që nga data 02.12.2013. Në momentin që kam kaluar si i punësuar primar në KRU "Prishtina", në kompaninë "Bajraktari" sh.p.k me seli në Maxhuraj, kam kaluar si i punësuar sekondar. Në kompaninë "Bajraktari" sh.p.k kam qene i punësuar në vitin 2009, për të vazhduar nga fillimi i vitit 2013, pastaj nga 02.12.2013-31.12.2019, kam qene i angazhuar si inxhinier – punë sekondare (part time). Gjate kësaj kohe kompania "Bajraktari" sh.p.k, shpesh here ka pas marrëveshje bashkëpunimi dhe marrëveshje konzorciumi me kompaninë "Milenium Konstruktion" sh.p.k.

Për projektin në fjalë "Vazhdimi i Rrugës B – Pjesa e dytë", me numër 616-19-1015-5-1-1 ky OE me aq sa kam informacion në mënyrë verbale, ka kërkuar dokumentacion nga kompania "Bajraktari" sh.p.k., mirëpo çfarë marrëveshjesh kanë pasur nuk e di, përderisa unë kam qene i angazhuar vetëm kohe pas kohe dhe jo në orar të plotë në kompaninë në fjalë.

Si përfundim ju njoftoj që firmosja e kësaj kontrate mbi vepër me OE "Milenium Konstruktion" sh.p.k. nuk është bërë nga ana ime, shihet qartësisht që në kontratë nuk është firma (nënshkrimi im). Nënshkrimi im është në CV-në e bashkëngjitur, mirëpo CV-ja e bashkëngjitur është e vitit 2018, jo e vitit 2019.

Sinqerisht,

Sokol Veli XHAFI



Prandaj duke paraqitur faktin e cekur më larte kërkojmë nga OSHP të ndërmerr të gjitha veprimet ligjore që i takojnë ndaj Operatorit Ekonomik për dokumentet të falsifikuar dhe OSHP të konstatojë se GOE Integral Shpk&Millenium Konstruktion Shpk është palë pa interes në aktivitetin e prokurimit në fjalë dhe lënda të kthehet në rivlerësim dhe të rekomandohemi për kontratë pasi që jemi Operator i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimit tretë nuk e shqyrton në pajtim me nenin 9 paragrafi 2 të Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave pretendimet ankimore të operatoreve ekonomik ankues duhet të jenë të njëjta, si tek kërkesa për Rishqyrtim edhe tek ankesa në OSHP. Ekspertet shqyrtues në pajtim me këtë dispozitë janë të obliguar që të shqyrtojnë vetëm pretendimet ankimore që janë të njëjta në kërkesën për Rishqyrtim dhe në ankesën në OSHP dhe të japin sqarim se disa nga pretendimet që janë në ankesë nuk kanë qenë pretendime ankimore të parashtruara në kërkesën për rishqyrtim sepse dispozita e lartcekur specifikon:

9.2 Ankesa do të dorëzohet në origjinal tek Organi Shqyrtues i Prokurimit "OSHP" dhe njëkohësisht, një kopje e ankesës do të dorëzohet Autoritetit Kontraktues. Pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me ato të paraqitura në Autoritetin Kontraktues.

4. Pretendimi i OE ankuesit kundër OE të rekomanduarit:

Për kërkesën a) Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë me tri vite përvojë pune pas diplomimit, kompania në fjalë ka kontratë me një kompani gjeodezike për shërbime gjeodezike mirëpo nuk ka kontratë të specifikuar për këtë aktivitet të prokurimit. Pra kontrata është poashtu para datës së njoftimit për kontratë.

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimit të katërt kundër OE të rekomanduarit lidhur me inxhinierin e Gjeodezisë konsideron se ky pretendim gjendet i pa bazuar, për faktin se OE i rekomanduar ka një marrëveshje kontraktuale me kompanin Gjeodeti i cili përfaqësohet nga vet pronari Gjeodet Nehat Sahiti B.I dhe ka po ashtu edhe licencën nga Agjencioni Kadastral i Kosovës, gjerësa edhe në FDT nga AK kërkohet inxhinier i gjeodezisë duke bashkangjitur CV, Diplomën, si dhe kontratën e punës ose marrëveshjen mbi angazhimin për këtë projekt. Po ashtu pretendimi i njëjtë është shqyrtuar edhe në vendimin e PSH 317/20 dt. 10.07.2020.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues "SABA BELCA; SB CONSTRUCTION SH.P.K; GURËBARDHI SH.P.K"- Obiliq, se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka kontratë me kompaninë gjeodezike për shërbime gjeodezike, mirëpo nuk ka kontratë të specifikuar për këtë aktivitet të prokurimit, si dhe ka kontratë me kompaninë gjeodezike e jo me gjeodetin si është kërkuar. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se tek njoftimi për kontratë dhe dosje të tenderit konkretisht te dëshmitë

Faqe 8 nga 10

dokumentare është kërkuar: "CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt. Referenca për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit për udhëheqësin e punishtes dhe inxhinierëve". Në rastin konkret, lideri i konsorciumit të operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës "INTEGRAL SHPK", ka marrëveshje kontraktuale biznesore me "NSH GJEODETI", ku kjo marrëveshje është lidhur me dt:12.10.2019, marrëveshja është e noterizuar, janë certifikatat e Biznesit dhe Numrit fiskal në emër të "NSH GJEODETI", dhe z. Nehat Sahiti , si dhe Diploma, CV-ja, Licenca dhe Referenca në emër të të njëjtit.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Ekspertja Shqyrtuese i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës të mbetet në fuqi.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 10.12.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se PAJTOHET me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 14.12.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se Nuk Pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Duke pranuar ekspertizën nga ekspertja me nr. 1028/20 te datës 10.12.2020, njoftojmë PSH. Nr. 1028/20 se duke pas provat tona gjatë qasjes ne dokumente dhe pas vlerësimit, ekzaminimit, krahasimit dhe hulumtimit tonë ne detaje, vlerësimin nga AK - ZPP dhe MENDIMI i ekspertes për këtë lëndë, ekspertet tanë vijën ne përfundim se ky aktivitet i prokurimit nuk është vlerësuar ne pajtim me dispozitat ligjore të LPP-ës,

Vëmendje/sqarim lidhur me veprimet e ZPP:

Ne vlerësimin e parë nga Komisioni i vlerësimit është rekomanduar për dliënie kompania jone SABA BELCA, mirëpo pas kërkesa për rishqyrtim nga GOE: INTEGRAL Shpk & MILLENIUM CONSTRUKTION Shpk, ZPP aprovon dhe kthen ne rivlerësim, ku me pas ZPP nxjerr njoftimin mbi vendimin e AK duke shpallur fitues GOE: INTEGRAL Shpk & MILLENIUM CONSTRUKTION Shpk, Ne te pakënaqur me këtë vendim kemi kërkuar qasje dhe pastaj Kërkesë për rishqyrtim dhe pastaj ANKESE

Faqe 9 nga 18

pran OSHP dhe PSH. nr. 317/20 date 10.07.2020 nxjerr vendim dhe lënda kthehet ne rivlerësim, dhe komisioni i rivlerësimit na rekomandon përsëri për dhënie te kontratës kompaninë tonë, mirëpo përsëri GOE: INTEGRAL Shpk & MILLENIUM CONSTRUKTION Shpk, bënë kërkesës për rishqyrtim dhe ankese ne OSHP dhe pas raporti te ekspertes e cila rekomandon qe lënda te kthehet ne rivlerësim, këtu ZPP, pajtohet me raportin e vlerësimit (lënda nuk shkon ne PSII), dhe PSH nxjerr NJOFTIM me nr. 20.10.2020 duke kthyer lenden ne rivlerësim, dhe komisioni i rivlerësimit DY nga anëtarët e këtij komisioni rekomandojnë për dhënie kompaninë tonë, kurse Kryetari i komisionit te këtij rivlerësimit e rekomandon për dhënie GOE: INTEGRAL Shpk & MILLENIUM CONSTRUKTION Shpk, dhe këtu fillon loja e **ZPP (i cili vazhdimisht nuk ka respektuar nenin 7 dhe 59 te LPP-se)**, refuzon rekomandimin e dy anëtarëve te komisionit te rivlerësimit dhe aprovon rekomandimin e Kryetarit te komisionit te rivlerësimit, duke nxjerr një njoftim mbi refuzimin e rekomanduar për dhënie te kontratës te datës 10.11.2020, duke jap një ARSYETIM krejt ne shkelje te dispozitave ligjore te LPP-se sepse thirret ne respektim te Vendimit te OSHP-se, me nr. 692/20 te datës 20.10.2020, gjeja se ne atë vendim.

Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit janë pranuar kontratat dhe AI< - Komisioni i rivlerësimit duhet te respektojnë. Kjo është një trillim nga ZPP sepse OSHP ka lëshuar një NJOFTIM me nr. 692/2020 te datës 20.10.2020 PASI QE ZPP QELLIMISHT ESIITE PAJTUAR ME RAPORTIN E EKSPERTES (raporti i ekspertes i cili është ne kundërshtim me nenin 114 te LPP-es, sepse përgjegjësia për vlerësim, ekzaminim dhe krahasim është ne diskrecion te AK dhe jo te ekspertes,), NE MENYRE QE OSHP TE NXJERR NJE NJOFTIM DHE JO TI JAP MUNDESIN PSH. TE NXJERR VENDIM, ME TE VETEMIN QELLIM QE TE NA DISKRIMONOJ DHE TE REKOMANDOJ PER DHEENIE GOE TE CILET NUK JAN TE PERGJEGJSHEM. Kjo është vërtetuar edhe me shikimet nga z. Sokol Xhafa, drejtuar ZPP si dhe shkresa e datës 30.11.2020 nga ZPP drejtuar neve dhe OSHP Gjithashtu ne NUK PAJTOHEMI me Mendimin e ekspertes ne fjalë, duke arsyetuar dhe argumentuar si ne vijim:

Lidhur me përgjigjen e eksperteve ne pretendimin nr. 1

Ne NUK pajtohem për faktin se ekspertja profesionale, japin vetëm një mendim pa ndonjë bazë ligjore te LPP-së, edhe vet e pranon ne këtë raport se është bazuar apo ja ka falc besimin ekspertit teknik i jashtëm i cili e ka trajtuar ne lenden 317/20 te datës 10.07.2020, pra te me fjale tjera te një raporti qe është kundërshtuar nga PSH. nr. 317/20 ku nuk janë pranuar disa kontrate te punëve qe kanë qene jashtë afatit 3 vjeçare nga njoftimi për kontrate dhe po aty ne atë vendim te PSII është kërkuar nga AK te veproje sipas nenit 59.2 dhe 72 te LPP-se dhe AK te beje vlerësimin, ekzaminimin, dhe krahasimin sipas nenit 59 te LPP-se, mirëpo përkundër kësaj AK - ZPP përveç qe nuk ka respektuar Vendimin e PSH. nr. 317/2020 te datës

10.07.2020 ai ka vazhduar edhe me lojna tjera duke vepruar ne kundërshtim me dispozitat ligjore si nenin 1, 2, 7, 59 dhe 60 te LPP-së, sepse përveç qe nuk ka kërkuar fare sqarime nga GOE te cilët ai vet i shpall si fitues dhe te përgjegjshëm - KETE FAKT TE MOS RESPEKTIMIT TE NENIT 59.2 DHE 72 TE LPP-SE, EKSPERTJA ëslitë dashtë ta cek ne raportin e saj dhe jo te ja jap besimin një eksperti teknik te jashtë për te cilin PSH nxjerr vendim kundër mendimit te tij. Ekspertja shkon edhe me tej duke kundërshtuar edhe vendimin e PSH. nr. 317/20 te datës 10.07.2020 duke jap sqarim se kontrata "Asfaltimi i rrugës ne Merdar" ne vlerë 194.187.96 euro dhe "Asfaltimi i disa rrugëve ne lagjen Ajeti ne fshatin Sfeqel" ne vlerë: 63,592.67 euro, janë brenda afatit te njoftimit për kontrate, kjo është sqaruar ne vendimin e OSHP-se PSH. nr. 317/20 te datës 10.07.2020 dhe këto kontrata janë realizuar jashtë periudhës 3 vjeçare nga njoftimi për kontrate dhe ato nuk pranohen dhe taslimi ekziston një vendim për këtë çështje dhe ekspertja ne fjale është dashtë te trajtoj si çështje te gjykuar "Res judicata" dhe jo te lëshohet ne këtë pretendim.

PO ashtu ekspertja ne këtë pretendim e gjenë pjesërisht te qëndrueshëm me shkeljet qe kanë ndodhur nga ZPP i cili përdor lojëra duke mos i respektuar vendimin e PSH. nr. 317/20 te datës 10.07.2020 por edhe duke bërë lajthitje anëtarët komisionit te vlerësimit dhe PSH, vetëm e vetëm te arrij te nënshkruaj kontrate me OE te shpallur fitues nga vet ai. Dhe këtu prerësi ekspertja rekomandon te mbetet ne fuqi vendimi i AK- ZPP duke bërë avokatin e ZPP dhe duke jap një raport jo profesional dhe ne kundërshtim me **nenin 114 pika iv)** te LPP-se, ku thotë: *"marrjen e çfarëdo masave të tjera të nevojshme për të korrigjuar shkeljet e bëra nga autoriteti kontraktues "*.

Lidhur me përgjigjen e eksperteve ne pretendimin nr. 2

Lidhur me këtë pretendim ekspertja kopjon një pjese te vendimin e PSH nr. 317/20 te datës 10.07.2020 duke konsideruar si **"res judicata"** mirëpo siç e cekem ne përgjigjen nr. 1 lidhur me kontrata ku ekspertja konsideron se janë brenda periudhës 3 vjeçare edhe pse ne vendim thuhet se nuk janë te pranueshëm këto kontrata sepse janë realizuar jashtë periudhës 3 vjeçare, prandaj konsiderojmë se ekspertja përveç qe është treguar jo profesionale, ajo ka treguar se ka qene e ndikuar nga palët e tjera te interesit. sepse ne këtë raport nuk ka treguar profesionalizmin dhe paanësi ashtu siç e obligon **neni 113 par. 2 i LPP-së**, ku thotë: *"Ekspertët shqyrtues, duhet të janë të paanshëm, dhe që kanë njohuri të lartë lidhur me zbatimin e aktivitetve te prokurimit si dhe te kenë njohuri per këtë ligj*

Lidhur me përgjigjen e eksperteve ne pretendimin nr. 3

Ekspertja nuk është përgjigjur saktë ne pretendimin tonë, por duke anashkaluar andaj ju rikujtojmë se lidhur me Inxhinierin e diplomuar - Hidroteknike **Hidroteknik z. Sokol V. XHAFA**, edhe pse te gjitha shkresat dhe dëshmitë ekzistojnë ne ankesën tone dhe i ka prezantuar ne raportin e saj, mirëpo edhe këtu Ekspertja ne fjale ka vepruar ne kundërshtim me rregulloren e OSHP nr. 01/2020 te datës 03.03.2020 e plotësuar dhe

ndryshuar me date 08.10.2020 konkretisht nenin 19 par. 1 te kësaj rregulloreje sepse ne raportin e saj nuk ka bere një ndarje te pretendimeve tone, pasi qe pretendimet tona lidhure me dispozitat ligjore te LPP-se janë identike dhe sigurisht nuk ka pas mundësi te beje një ndarje dhe ka qene obliguar te përgjigjet ne te gjitha pretendimet tona ankimore dhe te mos e vendos ne lajthitje PSLI por te përgatite një raport profesional dhe te arsyetoj ne dispozita ligjore te LPP-së, se AK ka respektuar apo nuk ka respektuar këtë apo atë dispozitë ligjore dhe jo jap një përshkrim sikurse një hartim i lirë pa asnjë nene apo dispozitë ligjore te LPP-së, **Nuk pajtohem i aspak me këtë raport te ekspertes ne fjale (loc kërkohet nga PSH te trajtoj drejt dhe te merr për baze provat dhe dëshmitë e prezantuar nga ana jonë, si para AK, ashtu edhe para PSH.**

Gjithashtu, ekspertes shqyrtuese ne fjale, fare nuk i ka lënë përshtypje kërkesa ne dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontrate po citoj: “Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt”, qe do te thotë se, **se inxhinieri i diplomuar i Hidroteknikes Z. Sokol (Veli) Xhafa**, ka nënshkruar **kontrate mbi vepër** nga te dy palët me **date 21.02.2019** por kjo kontratë nuk është ne pajtim te plotë me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontrate, dhe kjo gjë nuk mund te rregullohet as me **nenin 59.2 dhe 72 th LPP-së**, sepse kjo gjë nuk mund te dëshmohet se ka ndodhur para njoftimit për kontratë, prandaj duhet te shpallet i papërgjegjshëm sipas **nenit 59.4 te LPP-se**, dhe tash kjo gjë vërtetohet se kjo kontrate, nuk është nënshkruar fare nga te dy palët por është manipuluar nga GOE i rekomanduar nga ZPP krejt ne kundërshtim me **nenin 130 te LPP-së**.

Bashkangjitur me këtë shkese do gjeni shkresat/njoftimin nga z. Sokol Xhafa dhe e-inail-i nga ZPP

Lidhur me përgjigjen e eksperteve ne pretendimin nr. 4

Lidhur me këtë pretendim ekspertja ne fjale e ka trajtuar si gjetje te gjykuar duke shpallur pjesë nga Vendimi i PSH nr. 317/20 te datës 10.07.2020, duke u thirr ne ketë vendim aty ku i pelqen ekspertes në faje dhe aty ku nuk i pelqen ka jap sqarime, duke kundërshtuar këtë vendim ashtu siç e sqaruan ne përgjigjen 1 te kësaj shkrese (lidhure me kontrata e pranuar nga ekspertja) dhe duke ja lëshuar tërësisht besimin ekspertit teknik i cili ka qene i angazhuar ne ekspertizën nr. 317/20 te datës 11.06.2020 e te cilën ekspertize nuk i ka besuar as PSII, mirëpo kjo pike është sqaruar me vendim nga ana e PSII dhe ne pajtohem i me atë vendim sepse ato kontrata nuk pranohen janë jashtë periudhës 3 vjeçare.

Nuk pajtohem i me ekspertin ne fjale, nuk kane dhënë asnjë mendim apo konstatim duke mos e trajtuar drejtë pretendimet tona, por duke i dhënë një kahja krejt tjetër. Me fjale tjera, nuk është trajtuar fare pretendimet tona, duke u bazuar ne ndonjë bazë ligjore te LPP-së, për ta bere te besueshëm atë qe thotë ekspertja, por vetëm duke jap përshkrime, si pjesërisht te bazuar dhe ne fund rekomandon te aprovohet pjesërisht ankesa jonë, si e bazuar pa dhënë asnjë argument te bazuar ne ndonjë dispozite ligjore te LPP-së (ekspertja ne fjale është ndikuar vetëm ne procesverbalin hapjes dhe ka nxjerr një rekomandim te tille, pa

analizuar dispozitat ligjore te LPP) dhe ne kundërshtim detyrat dhe përgjegjësit qe dalin për ekspertin shqyrtues neni 114 par. 1 dhe 2 të LPP-së

Andaj, kërkojmë nga PSH te analizoj dhe te trajtoj saktë pretendimet tona, meqë për shkak te pandemisë COVID ' 19 OSHP nuk është duke mbajtur seanca dëgjimore për ti prezantuar dhe ofruar dëshmitë tona para PSH, andaj edhe një here kërkojmë te aprovohen si te bazuar pretendimet tona ankimore (pasi nga ekspertja për çudi nuk janë trajtuar drejtë dhe saktë, duke e bazuar me ndonjë dispozite ligjore te LPP-se, por vetëm duke përshkruar sikur e tregon ndonjë ndodh rasti ne rrugë) dhe ky aktivitet i prokurimit kërkojmë te kthehet ne RIVLERESIM dhe AK te respektoj ne tersi dispozitat ligjore te LPP-së dhe te vendoset drejt për këtë aktivitet te prokurimit.

Mbesim me shpresën se kërkesa jonë do të hasë në mirëkuptim tuaj!

Ju informojmë se ne baze te kërkesës se OE “Saba Bellca- Dega ne Kosove” te drejtuar ne forme elektronike ne E-mailin zyrtar me date: 23.11.2020, ju përgjigjem ne kërkesë si me poshtë:

Unë Sokol Veli Xhafa i datëlindjes 22.04.1985 me nr. Personal 2030491397, jam i punësuar ne nivelin primar ne KRU “Prishtina” sh.a qe nga data 02.12.2013. Ne momentin qe kam kaluar si i punësuar primar ne KRU Prishtina, ne kompaninë “Bajraktari” sh.p.k me seli ne Maxhunaj, kam kaluar si i punësuar sekondar. Ne kompaninë “Bajraktari” sh.p.k kam qene i punësuar ne vitin 2009, per te vazhduar nga fillimi i vitit 2013, pastaj nga 02.12.2013-31.12.2019, kam qene i angazhuar si inxhinier - pune sekondare (part time). Gjate kësaj kohe kompania “Bajraktari” sh.p.k, shpesh here ka pas marrëveshje bashkëpunimi dhe marrëveshje konzorciumi me kompaninë “Milenium Konstruktion” sh.p.k.

Për projektin ne fjale “**Vazhdimi i Rrugës B - Pjesa e dyte**”, me numër 616-19-1015-5-1-1 ky OE me aq sa kam informacion ne mënyrë verbale, ka kërkuar dokumentacion nga kompania “Bajraktari” sh.p.k., mirëpo çfarë marrëveshjesh kanë pasur nuk e di, përderisa unë kam qene i angazhuar vetëm kohe pas kohe dhe jo ne orar te plote ne kompaninë ne fjale.

Si përfundim ju njoftoj qe firmosja e kësaj kontrate mbi vepër me OE “Milenium Konstruktion” sh.p.k., nuk është bere nga ana ime, shihet qartësisht qe ne kontrate nuk është firma (nënshkrimi im). Nënshkrimi im është ne CV-n e bashkëngjitur, mirëpo CV-ja e bashkëngjitur është e vitit 2018, jo e vitit 2019.

Sokol Veli XHAFA



Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 15.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Saba Belca SHPK & Gurëbardhi" SHPK, se OE i rekomanduar nuk i plotëson kriteret dhe është i papërgjegjshëm sepse nuk plotëson shumicën e kriterëve të dhëna nga AK. Ky konsorcium gjatë dy vlerësimeve nga komisioni vlerësues është eliminuar për arsyen: "Nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme, (ndërtim i ultë) në vlerë minimale prej 3,000,000,00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë). OE ankues shton se ky konsorcium në ofertën e tyre ka përfshirë edhe kontrata të mirëmbajtjes dimërore që assesi nuk mund të jetë punë e ngjashme si dhe mirëmbajtjet verore. Po ashtu këto mirëmbajtje hyjnë në kontrata për shërbime dhe jo kontrata pune siç është ky aktiviteti i prokurimit. Gjithashtu shihet se së bashku si konsorcium kanë më pak se 1 milion euro kontrata të natyrës së ngjashme për 3 vitet e fundit. AK më saktësisht Udhëheqësi i Departamentit të Prokurimit ka marrë parasysh edhe disa pozicione të kontratës së mirëmbajtjeve për plotësimin e këtij kriteri mirëpo i ka anashkuar pa i analizuar edhe shumë kontrata të cilat i ka përfunduar në fund të vitit 2016 duke kërkuar nga kompania situacionet e tyre dhe të shihet se a e plotësojnë kriterin për realizimin e këtyre kontratave brenda 3 viteve të fundit. Pra më saktësisht kontrata: "Asfaltimi i rrugës në Merdar" me vlerë prej 194,187.69 Euro ka përfunduar me 20.12.2016. "Asfaltimi i disa rrugëve në lagjen Ajeti në fshatin Sfeqël" me vlerë prej 63,952.67 Euro e datës 19.12.2016, dhe afati kohorë i kërkesës për pranim teknik të punëve është zakonisht 5 deri 10 ditë, atëherë shihet shumë qartë se ekzekutimi i punëve lidhur me këto kontrata është në kundërshtim me kriteret e përzgjedhjes në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit d.m.th nuk është respektuar neni 59.4 i LPP-së, (d.m.th jashtë periudhe 3 vjeçare nga njoftimi për kontratë) gjithashtu ekspertët nuk janë lëshuar në fakte dhe prova që shumë lehtë kanë mund të vërtetojnë dhe të argumentohet se këto kontrata janë ekzekutuar jashtë periudhës 3 (tri) vjeçare nga njoftimi për kontratë dhe nuk duhet të pranohen, vetëm pse e kanë datën e pranimit brenda periudhës 3 (tri) vjeçare nga njoftimi për kontratë. Po ashtu shumë kontrata të tjera që kanë filluar në vitin 2014, 2015. Pra me të gjitha përpjekjet nga AK për të arritur vlerën e kërkuar shihet qartë se GOE nuk e plotëson këtë kriter. Në dosjen e Tenderit nuk kërkohen pozicione të ngjashme por kërkohen kontrata të ngjashme.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në ankesën paraprake, pretendimi ka qenë pothuajse i njëjti, ku është sqaruar se sa i përket projekteve mirëmbajtja e rrugëve dimërore dhe verore e cila më tepër është bazuar nga eksperti teknik i jashtëm i cili ishte i involvuar në lëndën 317/20 dt.10.07.2020 për të njëjtin pretendim, si rrjedhojë eksperti teknik ka sqaruar se disa nga pozicionet në projektet e mirëmbajtjeve dimërore dhe verore janë të natyrës ndërtim i ulët e të cilat përkojnë me kërkesën e AK-së, andaj ky aktivitet i prokurimit ka vazhduar në rivlerësim me qëllim që të rivlerësohen dhe ekzaminohen ofertat prej fillimit nga pika zero, ku AK ka vlerësuar se pozicionet janë të mirëqenë dhe përkojnë me natyrën e ngjashme. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues tutje sqaron, OE ankues në ankesë ka pretenduar po ashtu se disa kontrata nuk janë brenda afatit kohor të përfunduara brenda 3 viteve nga data e njoftimit për kontratë. Pra më saktësisht kontrata: "Asfaltimi i rrugës në Merdar" me vlerë prej 194,187.69 Euro ka përfunduar me

20.12.2016.

“Asfaltimi i disa rrugëve në lagjen Ajeti në fshatin Sfeqël” me vlerë prej 63,952.67 Euro e datës 19.12.2016. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ky pretendim nuk qëndron sepse kontratat “Asfaltimi i rrugës në Merdar” me vlerë prej 194,187.69 dhe “Asfaltimi i disa rrugëve në lagjen Ajeti në fshatin Sfeqël” me vlerë prej 63,952.67 Euro në ofertën e OE të rekomanduarit në listë janë brenda afatit nga data e njoftimit publikimit për kontratë pra 02.12.2016-02.12.2019.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues tutje në këtë pretendim shton se: “Komisioni i rivlerësimit në këtë rast ka vepruar drejtë duke mos i marrë parasysh kontratat për shërbim, ndërsa Udhëheqësi i Departamentit të Prokurimit e refuzon rekomandimin e tyre dhe merr vendim që të shpërblej me kontratë Grupin e Operatorëve Ekonomik Integral & Milenium duke mos kërkuar as edhe sqarim shtesë për këto kontrata. Pra Udhëheqësi i Departamentit të Prokurimit ka vepruar në kundërshtim me vendimin e Panelit Shqyrtues me nr. 317/20”. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pretendimi gjendet pjesërisht i qëndrueshëm, komisioni i vlerësimit në rivlerësim nga 3 anëtarë të komisionit 2 kanë qenë kundër OE të rekomanduarit, ndërsa njëri ka qenë pro rekomandimit, mirëpo konform Rruopp-së pika 40.13 vendimi përfundimtar i mbetet ZPP-së citat:

40.13 Vendimi përfundimtar mbi dhënien e kontratës mbetet përgjegjësi e Zyrtarit përgjegjës të Prokurimit. Zyrtari përgjegjës i Prokurimit mund të pranojë rekomandimin e komisionit apo refuzojë atë. Kur refuzohet rekomandimi i komisionit, Zyrtari përgjegjës Prokurimit do të shpjegojë arsyet me shkrim. Në situata të tilla Zyrtari përgjegjës i Prokurimit mund të nxjerr vendimin përfundimtar ose mund të formoj komision të ri për ri-vlerësim. Shpjegim i tillë do të përfshihet në procesverbalin e aktivitetit të prokurimit. ZKA i AK-së menjëherë do të informohet për këtë refuzim. Informacioni duhet të jepet me shkrim.

Pretendimi tjetër i OE ankues kundrejt OE të rekomanduar ka të bëjë me dokumentet e dorëzuara të personelit i cili do të jetë i angazhuar në këtë projekt nga kompania e shpërblyer me kontratë shihet se GOE Integral Shpk & Millenium Construction nuk plotëson gati asnjë nga këto kritere. Për: a) Inxhinier i diplomuar i hidroteknikës dhe b) Inxhinier i diplomuar i elektroteknikës (drejtimi energjetike) nuk plotësohet kriteri për udhëheqje të kontratave të natyrës së ngjashme pasi referencat e tyre janë për projekte të tjera.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pretendimi i OE ankuesit është shqyrtuar në vendimin 317/20 dt.10.07.2020, dhe se OE i rekomanduar ka të bashkangjitur referencat për inxhinierët në fjalë.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues “SABA BELCA; SB CONSTRUCTION SH.P.K; GURËBARDHI SH.P.K”- Obiliq, se inxhinieri i hidroteknikës dhe inxhinieri i elektros, ofruar nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës, nuk e plotësojnë kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë ku kërkohet: “Referenca për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit”. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ky pretendim ankimor është i pa bazuar pasi që këto referenca i ka bashkangjitur eksperti në ekspertizën e tij.

Në pretendimin tjetër të OE ankues i cili shton: ne kemi dyshuar prej fillimit se Operatori Ekonomik "GOE Integral Shpk & Millenium Construction" ka paraqitur dokumente të rreme dhe kemi paraqitur dyshime të cilat i kemi cekur në Përgjigjen ndaj mendimit të ekspertit të datës 15.06.2020 por që nuk janë investiguar dhe nuk janë hulumtuar si duhet dhe as që nuk është urdhëruar AK për verifikimin e këtyre dokumenteve të ofruara. AK në anën tjetër ex-officio është dashur të bëjë verifikimin e këtyre dokumenteve të cilat nuk janë të dorëzuara origjinal. Ne si kompani është dashur që të vërtetojmë se a janë të gjitha dokumentet e ofruara të besueshme dhe personeli profesional a është në dijeni për angazhimin e tyre në këtë projekt. Pasi që nuk është bërë nga AK verifikimi i dokumenteve, ne kemi bërë kërkesë drejtuar Sokol Xhafës në emailin e tij zyrtar më datën 23.11.2020, se a është i angazhuar si Inxhinier i Diplomuar i Hidroteknikës me dijeninë e tij për arsye se nënshkrimi i vendosur në Kontratën mbi vepër nuk është i njëjtë me atë në CV si dhe dokumenteve të nënshkruara në KRU Prishtina. Prandaj duke paraqitur faktin e cekur më larte kërkojmë nga OSHP të ndërmerr të gjitha veprimet ligjore që i takojnë ndaj Operatorit Ekonomik për dokumentet të falsifikuar dhe OSHP të konstatoi se GOE Integral Shpk & Millenium Konstruktion Shpk është palë pa interes në aktivitetin e prokurimit në fjalë dhe lënda të kthehet në rivlerësim dhe të rekomandohemi për kontratë pasi që jemi Operator i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se sa i përket pretendimit të tretë nuk e shqyrton ne pajtim me nenin 9 paragrafi 2 të *Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave* pretendimet ankimore të operatoreve ekonomik ankues duhet të jënë të njëjta, si tek kërkesa për Rishqyrtim edhe tek ankesa në OSHP. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në pajtim me këtë dispozite janë të obliguar që ti shqyrtojnë vetëm pretendimet ankimore që jenë të njëjta në kërkesën për Rishqyrtim dhe në ankesën në OSHP dhe të japin sqarim se disa nga pretendimet që janë në ankesë nuk kanë qenë pretendime ankimore të parashtruara në kërkesën për rishqyrtim sepse dispozita e lartcekur specifikon:

9.2 Ankesa do të dorëzohet në origjinal tek Organi Shqyrtues i Prokurimit "OSHP" dhe njëkohësisht, një kopje e ankesës do t'i dorëzohet Autoritetit Kontraktues. Pretendimet ankimore duhet të jënë të njëjta me ato të paraqitura në Autoritetin Kontraktues.

Paneli shqyrtues gjithashtu konstaton se ankesa nuk duhet të parashtrohet në Organin Shqyrtues të Prokurimit në kundërshtim me nenin 9 pika 1 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pranë autoriteti kontraktues, parashtrimi të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave sepse neni i lartcekur specifikon se: Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes dhe të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-së, pra kërkesa për rishqyrtim duket të jetë si një fazë e detyrueshme paraprake në mënyrë që

të paraqitet një ankese pran OSHP-së, neni 109, paragrafët 1 dhe 2, në fakt parashikojnë që: 1. Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankese pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. 2. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Për më tepër neni 111, paragrafi 1.9, parasheh se: "çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankese pranë OSHP-së, megjithatë, OSHP-ja do të marrë masa vetëm nëse ankesa e tillë: 1.9 e ka të bashkangjitur një kopje të vendimit të miratuar nga autoriteti kontraktues gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A; dhe Pra, nga leximi i përbashkët i dispozitave të përmendura më lart, është e qartë se shqyrtimi paraprak pranë AK në fjalë është një fazë paraprake e detyrueshme që duhet të ndodh para parashtrimit të ankesës në OSHP.

Lidhur me pretendimin e radhës nga OE ankues se për kërkesën a)inxhinier i diplomuar i gjeodezisë me tri vite përvojë pune pas diplomimit, kompania në fjalë ka kontratë me një kompani gjeodezike për shërbime gjeodezike mirëpo nuk ka kontratë të specifikuar për këtë aktivitet të prokurimit. Pra kontrata është po ashtu para datës së njoftimit për kontratë.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se sa i përket pretendimit të katërt kundër OE të rekomanduarit lidhur me inxhinierin e Gjeodezisë konsideron se ky pretendim gjendet i pa bazuar, për faktin se OE i rekomanduar ka një marrëveshje kontraktuale me kompaninë Gjeodeti i cili përfaqësohet nga vet pronari Gjeodet Nehat Sahiti B.I dhe ka po ashtu edhe licencën nga Agjencioni Kadastral i Kosovës, gjersa edhe në FDT nga AK kërkohet inxhinier i gjeodezisë duke bashkangjitur CV, Diplomën, si dhe kontratën e punës ose marrëveshjen mbi angazhimin për këtë projekt. Po ashtu pretendimi i njëjtë është shqyrtuar edhe në vendimin e PSH 317/20 dt. 10.07.2020.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, sqaron se autoriteti kontraktues ka bërë vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe në bazë të kriterëve të përcaktuara të dosjes së tenderit.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, ndërsa autoriteti kontraktues në këtë rast ka vepruar konform këtij neni. Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet

të prokurimit ka marr parasysh dhe ka vepruar duke pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK "KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS";
- 1x1 OE "Saba Belca SB Construction &Gurebardhi" SHPK;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.